



### VËRTETIM I NJËSISË ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 04.08.2020 (dymijë e njëzet), në Dhomën e Noterisë Tiranë, përpara meje noteres, Edlira Malaj (Galanxhi), me seli në Rr."Sami Frashëri" Tiranë, u paraqit personalisht:

Znj. Marsilda Shima, dtl 29/01/1993, banuese në Tiranë dhe e pajisur me mjet identifikimi 028692942, e cila më kërkoi të vërtetoj me origjinalin fotokopjen për emër të shoqërisë "Loloçi and Associates";

***Vendimin Nr. 101, datë 29.07.2020 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, për miratimin e pjesëmarrjes influencuese në shoqërinë e sigurmit "Sigal Uniqa Group Austria" Sh.a..***

Për të cilën pasi bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit të nxjerrë nga dokumenti origjinal dhe rezultoi se nuk ka korigjime, shtesa apo fshirje e shenja të tjera, e **vërtetoj njësinë me origjinalin** në bazë të nenit 56 të ligjit 7829 datë 01.06.1994 'Për Noterinë' dhe 'Udhëzimit të Ministrisë të Drejtësisë' me nr 6291 datë 17.08.2005 pika 3, 4, 7.

NOTERE

EDLIRA O. MALAJ (GALANXHI)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI

VENDIM

Nr. 101, datë 29.07.2020

PËR  
MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE NË SHOQËRINË E SIGURIMIT  
“SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 48, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Rregullores nr. 1, datë 25.01.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

VENDOSI:

1. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese të aksionarit të ri, shoqërisë “UNIQA Österreich Versicherungen AG”, në nivelin 86.93% në kapitalin e shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a., si aksionar influencues.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR  
Deniz DERALLA



DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE